



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 korrik 2014
Nr.ref.:RK674/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI30/14

Parashtrues

**Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe
Hyzri Delolli**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së njoftimit të Ministrisë së
Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29
gushtit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Zymrije Haxhimusa, me vendbanim në fshatin Doganaj, komuna e Ferizajt; z. Ekrem Abazi, me vendbanim në Viti; znj. Ferinaze Isufi, me vendbanim në Prishtinë; z. Avdullah Hoxha, me vendbanim në fshatin Pleshinë, komuna e Ferizajt; dhe z. Hyzri Delolli, me vendbanim në fshatin Zaskok, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesit).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë njoftimin e Ministrisë së Administratës Publike, nr. 4278, të 29 gushtit 2013 (në tekstin e mëtejme: MAP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit të MAP-it, nr. 4278, të 29 gushtit 2013, përkitazi me pretendimet e parashtruesve për shkelje të nenit 45. 1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; dhe nenit 73 [Pamundësia e Kandidimit] të Kushtetutës, si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit procedural, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 shkurt 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI30/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI30/14, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.
7. Më 4 mars 2014, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë.
8. Më 8 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta plotësimin e saj me dokumentacion relevant.
9. Më 22 prill 2014, parashtruesit dorëzuan formularin e plotësuar, por nuk kanë bashkëngjitur asnjë dokument relevant.
10. Më 23 prill 2014, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi MAP-in, respektivisht sekretarin e përhershëm dhe kërkoi dokumente shtesë.
11. Më 28 prill 2014, MAP-i dorëzoi dokumente shtesë, përkitazi me rastin në fjalë.
12. Më 26 qershor 2014, Gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoj me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

13. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesit e kësaj kërkesë, në zgjedhjet e fundit lokale, të organizuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), janë zgjedhur anëtarë të kuvendeve komunale, në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës. Parashtruesit njëkohësisht punojnë si nëpunës civilë në institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës.
15. Më 29 gusht 2013, MAP-i me njoftimin, nr. 4278, të 29 gushtit 2013, i kishte informuar të gjithë nëpunësit civilë, përkitazi me të drejtat dhe obligimet sipas Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, të cilët kushtimisht do të dëshironin të kandidonin në zgjedhjet komunale të vitit 2013, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.
16. Më 2 dhjetor 2013, parashtruesit, pas përfundimit të zgjedhjeve, janë kthyer në vendet e tyre të punës dhe kanë pranuar pagën mujore për muajin dhjetor. Më pas, siç pohojnë të njëjtët, MAP-i i largoi nga lista e pagave për muajin janar 2014, për shkak të zgjedhjes së tyre si asambleistë të kuvendeve komunale, në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që të futen në sistemin e pagave, si nëpunës nga ana e MAP-it, meqë pretendojnë se pa të drejtë janë hequr nga lista e pagave nga muaji janar 2014. Me këtë veprim parashtruesit pretendojnë se u është shkelur e drejta për punë dhe për paga, si dhe e drejta për zgjedhje dhe për t'u zgjedhur.
18. Parashtruesit pretendojnë se largimi i tyre nga lista e pagave për muajin janar 2014 është i paligjshëm. Ata mëtojnë: *“ne parashtruesit e ankesës kemi marr pjesë në zgjedhjet e fundit lokale, të cilat u organizuan nga KQZ, në territorin e Republikës së Kosovës dhe jemi zgjedhur këshilltarë komunal, dhe ne u përkasim subjekteve të ndryshme politike, por në vendet e punës ku ne punojmë, verbalisht na është kumtuar se MAP, na ka larguar nga lista e pagave për muajin janar, pasi qe ne jemi zgjedhur asamblistë komunal, me arsyetimin se ne duhet të heqim dorë nga vendet e punës, ku kemi qenë dhe jemi të punësuar deri me tani”*.
19. Për më tepër pohojnë: *“shkeljet esenciale të dispozitave procedurale konsistojnë në faktin se, zgjedhjet e fundit lokale janë mbajtur sipas Ligjit Nr. 03/L-072, i cili ligj vlen vetëm për shërbyes civil në Komuna, dhe ne jemi certifikuar nga KQZ-ja. Pra sipas dispozitave të këtij Ligji dorëheqje nga puna duhet të japin vetëm shërbyesit civil qe janë te punësuar në Kuvende Komunale të cilët janë në konflikt interesi. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 MAP-Nr. 01/2010 MAPL, neni 2. paragrafi 1, paragrafët prej 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, kur kësaj t'i shtohet edhe Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 17.4, i cili nen thotë, citojmë: Shërbyesit civil, qe janë zgjedhur në zgjedhjet Komunale dhe qendrore kanë të drejtë të*

aplikojnë dhe të konkurrojnë me kandidatë të tjerë për cilëndo pozitë të lirë në shërbimin civil”.

20. Parashtruesit pohojnë se edhe para këtyre zgjedhjeve lokale kanë qenë të zgjedhur si asambleistë komunalë për disa mandate radhazi, prandaj kërkojnë që edhe tani t’u mundësohet ushtrimi i këtij funksioni, dhe po ashtu të vazhdojnë të punojnë si nëpunës civilë në administratën qendrore.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata para së gjithash vlerëson nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret procedurale të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.
22. Parashtruesit në rastin konkret janë persona fizikë, të cilët kërkesën e tyre e bazojnë në nenin 113.7 të Kushtetutës.
23. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, parashtruesit e kërkesës ankohen ndaj vendimit të MAP-it, me të cilin pretendojnë se padrejtësisht janë hequr nga lista e pagave për muajin janar 2014. Parashtruesit janë zgjedhur asambleistë komunalë në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe janë certifikuar nga KQZ-ja. Ata pretendojnë se heqja e tyre nga lista e pagave në vendet ku kanë punuar është në kundërshtim me ligjin dhe nuk vlen për të njëjtit, por vetëm për shërbyesit civilë të cilët janë në konflikt interesi sipas ligjit.
25. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kësaj kërkesë kanë dështuar të provojnë se i kanë shteruar mjetet efektive juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi.
26. Në këtë kontekst, parashtruesit para se të dorëzonin kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese, do të duhej shteruar të gjitha mundësitë në procedurë administrative, përkatësisht të kërkonin zgjidhjen e çështjes së tyre brenda MAP-it dhe më pas në gjykatën kompetente, përkatësisht në Departamentin për çështje Administrative.
27. Gjykata dëshiron të theksojë se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t’i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi është përgjegjës kur rasti i tij/saj shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon t’i shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

(shih, Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI142/13, i 22 tetorit 2013, *Fadil Maloku, kundër Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës Nr. 686-2013*, të 6 shtatorit 2013).

28. Nga arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, pasi që parashtruesit nuk i kanë shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani